



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 295, Datë 18.11.2022

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “H & E ENERGY”
SH.P.K. NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2 gërma “d” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “e”, nenit 5, pika 1 gërma “e”, nenit 10, pikat 1 dhe 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 dhe 19 pika 1 gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE, nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 18.11.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1949/5 prot., datë 16.11.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “H & E ENERGY” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “H & E ENERGY” sh.p.k. me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1935 prot., datë 09.11.2022, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.5); Shtojcën 1 dhe Shtojcën 1E të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të aplikimit (Aneksi A).

- Aplikuesi ka depozituar për llogari të ERE-s një shumë më të madhe sesa pagesa e aplikimit e përcaktuar në Aneksin A, të rregullores së licencimit, ndaj në të tilla rrethana, pagesa shtesë do t'i kthehet.
- Nga aplikimi rezulton se shoqëria “H & E ENERGY” sh.p.k., në zbatim të rregullores ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, gërmat “a”, “b”, dhe “c”; për pikën 1.2, gërmat “a”, “b” dhe “d”, për pikën 1.3, gërmat “a”, “b” dhe “c” dhe pikën 2.5.
- Nga ky aplikim rezulton se në zbatim të nenit 9, pikës 1.2, gërmës “c”, shoqëria ka depozituar në ERE strukturën e organizimit të saj, por duke qënë se shoqëria ka një objekt të gjerë veprimtarie, duhet të bëjë me dije në ERE stafin teknik që do të angazhohet në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike.
- Në lidhje me informacionin mbi stafin teknik që do të angazhohet në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike, do të njoftohet shoqëria ta përcjellë atë brenda afateve të përcaktuara nga ERE.
- Në kuadër të plotësimit nga Aplikuesi të dokumentacionit thelbësor sipas kërkesave të rregullores, vlerësohet fillimi i procedurës për këtë aplikim.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “H & E ENERGY” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI